

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Nipon Ekspres Holdings, Ink (Nippon Express Holdings, Inc.), me seli të regjistruar në Ndërtesën e Grupit EnEks, Kanda, Izumiço 2, Çijoda-ku, 101-0024 Tokio, Japoni, dorëzuar përmes avokatit Lupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 17.12.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin Nipon Ekspres Holdings, Ink (Nippon Express Holdings, Inc.), me seli të regjistruar në Ndërtesën e Grupit EnEks, Kanda, Izumiço 2, Çijoda-ku, 101-0024 Tokio, Japoni, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi SH Holdko GmbH (SH HoldCo GmbH), me seli në Haid-und-Noj-Shtr. 13-15, 76131, Karlsrue, Gjermani, përmes blerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 12.11.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga Nipon Ekspres Holdings, Ink (Nippon Express Holdings, Inc.), me seli të regjistruar në Ndërtesën e Grupit EnEks, Kanda, Izumiço 2, Çijoda-ku, 101-0024 Tokio, Japoni, me të cilin Nipon Ekspres Holdings, Ink synon të fitojë kontroll të pavarur mbi grupin e shoqërive Simon Hegele „Grupi Simon Hegele“) përmes blerjes së të gjitha pjesëve në SH Holdko GmbH (SH HoldCo GmbH), me seli në Haid-und-Noj-Shtr. 13-15, 76131, Karlsrue, Gjermani, përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Nipon Ekspres Holdings, Ink. është një shoqëri japoneze me seli në Tokio, e listuar në Bursën e Tokios. Operon në nivel global (në Japoni, Amerikën e Jugut dhe të Veriut, Evropë, Azinë Lindore dhe Azinë Jugore dhe Oqeani) si një ofruer global i shërbimeve logjistike, duke përfshirë shërbimet e magazinimit, transportin vendor dhe ndërkombëtar përmes hekurudhës, detit ose ajrit.

Produktet dhe shërbimet e Nipon Ekspres Holdings, Ink janë pjesë përbërëse e katër segmenteve raportuese, përkatësisht logjistikës, transportit të sigurt, transportit dhe ndërtimit të mallrave të rënda, si dhe mbështetjes logjistike.

Në Maqedoninë e Veriut, Nipon Ekspres Holdings, Ink.. ka një shoqëri të varur të regjistruar:

KARGO-PARTNER LOGISTIKS SHPKNJP Shkup (me seli të regjistruar në rr. Orce Nikolov nr. 111/1-1, 1000 Shkup, dhe aktivitet të regjistruar 52.29 - Aktivitete të tjera mbështetëse në transport).

Grupi **Simon Hegele** është një furnizues aktiv i shërbimeve dhe logjistikës në nivel global me fokus në sektorin e shëndetësisë, kryesisht i vendosur në Gjermani dhe në një masë më të vogël në Francë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Meksikë, Australi, Brazil, Singapor dhe Turqi.

Grupi Simon Hegele nuk është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Ана Николоска